



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:081336

Datë: 24.11.2020

Numri i dokumentit: 01294073

C.nr.229/2019

Gjykata Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Besnik Pireva, në çështjen kontestimore të paditësit B. S i në Gjilan, kundër të paditurës TEB sh.a me seli kryesore në Prishtinë dhe me degën e saj në Gjilan me adresë në .. të cilën e përfaqëson B.H avokat në Prishtinë, me objekt kontesti anulim i vendimit dhe kompensimi i diferencës në pagë, vlera e kontestit 5,000.00 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesore në prani të paditësit dhe përfaqësuesit të paditurës, më datë 09.11.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet kërkesëpadia e paditësit B. S në Gjilan, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës TEB sh.a, me seli kryesore në Prishtinë, dhe me degën e saj në Gjilan me adresë në, mbi ndërrimin e pozitës dhe degës në drejtim të paditësit, dhe të obligohet e paditura që paditësit i'a kompensoj diferencën në pagë edhe atë për çdo muaj nga 400 euro, duke filluar nga data 01.01.2014 e deri me datën 15.10.2015, si dhe përfitimet e tjera të humbura gjatë kësaj kohe duke përfshirë shpenzimet e udhëtimit nga 5 euro për çdo ditë ose 0.16 euro për 1 km, për orarin e zgjatur si pasojë e udhëtimit në relacionin Gjilan-Prishtinë-Gjilan, **si e pabazuar**.

II. Detyrohet paditësi B. S në Gjilan, që të paditurës TEB sh.a me seli kryesore në Prishtinë, dhe me degën e saj në Gjilan me adresë në, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 80 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit B. S në Gjilan, në këtë gjykatë me datë 21.03.2019 ka ushtruar padi, kundër të paditurës TEB sh.a me seli kryesore në Prishtinë, dhe me degën e saj në Gjilan me adresë në me objekt kontesti anulim i vendimit dhe kompensimi i diferencës në pagë si dhe përfitimeve tjera të humbura, vlera e kontestit 5,000.00 euro.

Paditësi si në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së ushtruar në këtë gjykatë, kundër të paditurës duke theksuar se fillimisht paditësi ka punuar te e paditura si menaxher i degës në Gjilan, për priudhën kohore nga data 13.09.2010 deri me datën 31.12.2013, me pagë mujore pre 1,900 euro. Me datën 04.11.2013 nga e paditura i është kumtuar vendimi se të njëjtit i ndrohet prozita e tij e punës për shkak të performancës së dobët dhe nga menaxheri i degës në Gjilan, në pozitën M. i K. të B në zyrën qendrore të të paditurës në Prishtinë, e duke u gjendur para një pozite të vështirë, dhe në pamundësi të zgjedhjes së një alternative të tretë e kishte pranuar pozitën e re të punës te e

paditura dhe kishte nënshkruar kontratën e titulluar Aneksi II i kontratës së punësimit, me të cilën kontratë është degraduar në pozitë, është transferuar nga Gjilani në Prishtinë, dhe po ashtu i'u kishte ulur paga mujore nga 1,900 euro në 1,500 euro për muaj. Me tej ka theksuar se i pa kanqur me këtë vendim me datën 15.10.2015 i është drejtuar të paditurës që e njëjta ta rishikoj vendimin e muajit nënkor 2013, ku e paditura i kishte kthyer përgjigje përmes interne të TEB në Gjilan, dhe e adresuar në adresë të menaxherit të TEB dega në Gjilan A. S e ky i fundit përgjigjen ja kishte dorëzuar me datën 24.03.2016, ku pastaj i njëjti me shkresë tjetër i është drejtuar edhe selis krejsore të TEB në Turqi, por nga e njëjta nuk ka marr përgjigje.

Gjatë shqyrtimit gjyqësorë, paditësi i ka kundërshtuar pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesave të tij duke theksuar se baza juridike e padisë është kompensimi i diferencës në paga, si dhe përfitimeve të tjera të humbura, pasi që kërkesa është brenda afateve të parapara me ligjin e punës, pasi që paditësi përgjigjen e të paditurës e ka pranuar me datën 24.03.2016, qka do të thotë se kjo padi është ushtruar pa kaluar afati 3 vjeçarë, dhe nuk mund të aplikohet dispozita e nenit 79 të ligjit të punës, pasi që padia nuk është ushtruar për kthimin në vendin e punës. Mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj kërkesëpadinë e tij si të bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura, me përgjigjen në padi, ka deklaruar se e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se e njëjta nuk e ka bazën e duhur juridike, në kundërshtim me thënjet dhe provat e parashtruara nga ana e paditësit, dhe se e njëjta kërkesë është e parashkruar, duke theksuar se paditësi me pajtimin e vetë e ka nënshkruar Aneksin II të kontratës së punësimit me datën 17.12.2013, dhe atë pa asnjë vërejtje dhe me vullnet të plotë e që vërtetohet me veprimet konkludente të paditësit nga se i njëjti ka qëndruar për dy vite në vendin e punës pa asnjë vërejtje, dhe paditësi me datën 25.09.2015, ka parashtruar dokumentin e dorëheqjes me të cilin ai vetë ka shkëputur mardhënjen e punës. Paditësi padinë e ka ushtruar me datën 21.03.2019, ndërsa vendimi për ndërprerjen e mardhënjes së punës është nxjerrë me datën 15.10.2015, e që brenda afatit vijues prej 30 ditësh ka mundur të inicoj kontest pune në gjykatë në rast se ka menduar se vendimi i ka shkelur të drejtat e tij, pavarësisht përgjigjes së të paditurës. Gjithashtu, e paditura e ka kontestuar edhe kompensimin e diferencës në pagë nga se konsideron se e njëjta nuk ka asnjë obligim ndaj paditësit, por gjithashtu thekson se kërkesa nga mardhënja e punës në para është parashkruar sepse paditësi ka pasur afat 3 vite, ndërsa i njëjti padin e pa ushtruar pas afatit prej 3 vite.

Gjithashtu, në shqyrtimin gjyqësorë e paditura përmes të autorizuarit të saj, ka vazhduar ta kontestoj kërkesëpadinë e paditësit si të parashkruar dhe pa bazë juridike duke i propozuar gjykatës që padia e paditësit të hudhet poshtë si e pasafatshme apo e njëjta të refuzohet në tërësi si e pabazuar, shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për përfaqësimin në një seancë në shumën prej 80 euro.

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: korespondenca e datës 04.11.2020, e bërë nga TEB për ndërimin e pozitës së punës së paditësit, vlerësimi i performancës për vitin 2013, dhe memo e bankës për vlerësimin e performancës në gjuhën angleze, kontrata e punësimit e datës 13.09.2020, kontrata e punësimit e datës 16.12.2020, aneksi II i kontratës së punësimit i datës 17.12.2013, aneksi III i kontratës së punësimit i datës 11.07.2014, kërkesa e datës 15.10.2015 e ushtruar nga paditësi ndaj të paditurës, plikojat e përgjigjes e datës 11.11.2015, kërkesa drejtuar TEB në Turqi e datës 06.04.2016, vendimi për ndërprerjen e mardhënjes së punës nga i punësuar i datës 15.10.2015 dhe aktдорheqja e paditësit nga mardhënja e punës e datës 25.09.2015.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar

çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, pasi që erdhi në përfundim se kërkesa e paditësit ka arritur afatin e parashkrimit.

Gjykata, gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka konstatuar se në mesë palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestues fakti se paditësi prej datës 13.09.2010 deri më datën 31.12.2013, ka qenë i punësuar në pozitën e menagjerit të bankës TEB dega në Gjilan, po ashtu nuk ka rezultuar kontestues fakti se paditësi nga data 01.01.2014 deri me datën 15.10.2015, sipas aneksit II të kontratës së punësimit kishtë kaluar në pozitën e mbikqyrës i kontrollit të mbrendshëm të e paditura në zyrën qëndrore në Prishtinë, ndërsa sipas aneksit III në mes palëve ishte lidhur kontrata në afat të pa caktuar për pozitën e mbikqyrës të kontrollit të mbrendshëm me datën 11.07.2014, nuk ka qenë kontestues as fakti se paditësi me datën 25.09.2015, ka parashtruar dorëheqjen e një anshme nga mardhënja e punës, ndërsa e paditura ne bazë të kësaj me datën 15.10.2015, kishtë nxjerrur vendim për ndërprerjen e mardhënjes së punës nga i punësuar i të cilin vendim e kishtë pranuar paditësi me datën e njëjtë, dhe ndaj të cilin vendim nuk kishtë ushtruar ankesë.

Kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse ka qenë fakti nëse kërkesëpadia e paditësit ka arritur parashkrimin.

Me qenëse pala e paditur në këtë çështje kontestimore është thirrur në parashkrim, ndërsa faktet e tjera nuk kanë qenë kontestuese në mesë palëve ndërgjyqëse, gjykata në këtë çështje është lëshuar vetëm në vërtetimin fakteve lidhur me pretendimet e palës së paditur sa i përket parashkrimit të kërkesëpadisë së paditësit.

Me Ligjin e Punës nr. 03/L-212, në nenin 78 paragrafi 1 është paraparë se “*I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura*“, ndërsa në paragrafin 2 të po kësaj dispozite parashihet se “*Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës*”, me nenin 79 të po këtij ligji “*Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente*” ndërsa me nenin 87 të ligjit të lartëcekur është paraparë se “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”. Me ligjin për Mardhëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 (LMD), me nenin 341 është paraparë se “*Me parashkrim shuhet e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Gjykata nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë.*”, me nenin 342 paragrafi 1 të këtij ligji është paraparë se “*Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër*”, me nenin 343 parashihet “*Parashkrimi lind, kur të ketë skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj*”, ndërsa me nenin 353 paragrafi 1 parashihet se “*Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike akcesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë*”, ndërsa me nenin 372 të LMD-së parshihet se “*Për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin*”.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të administruara, si dhe fakteve jokontestuese në mes palëve ndërgjyqëse, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga se fillimisht kërkespacia e paditësit në këtë çështje është anulimi i vendimit mbi ndrimin e pozitës i konkretizuar me Ankesin II të kontratës së punësimit të lidhur në mes palëve ndërgjyqëse me datën 17.12.2013 me të cilën kontratë palët ndërgjyqëse janë pajtuar për ndryshimin e pagës dhe pozitës së paditësit nga menagjer i degës në Gjilan, në pozitën mbikqyrës i kontrollit të mbrendshëm të selia Qendrore në Prishtinë. Gjykata vlerëson se paditësi ndaj akteve të lartëcekura të nxjerra nga e paditura nuk ka ushtruar asnjë mjet juridik për atakimin e tyre por në bazë të Aeksit II palët janë pajtuar për një gjë të tillë dhe rrejdhimisht anulimi i vendimit në kuptim të nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës është si i pasafatshëm nga se paditësi për anulimin e vendimit 17.12.2013 me kërkesë i ishte drejtuar të paditurës me datë 15.10.2015, ndërsa padinë e ka ushtruar me datën 21.03.2019, e për të cilin afat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare nga se një afat i tillë është i karakterit prekluziv, kurse me kalimin e këtij afati humbet e drejta për ushtrimin e padisë. Meqenëse padia e paditësit ka qenë edhe në drejtim edhe të kompensimit të diferencës së pagave gjykata lidhur me kërkesën e paditësit për anulimin e vendimit vendosi me këtë vendim (dhe jo me vendim të veçantë për ta hudhur posht si të pasafatshme).

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike gjykata ka gjetur se në këtë çështje kontestimore edhe sa i përket kërkespadiës së paditësit lidhur me kompensimin e diferencës në paga, ka pushuar e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit përmes gjykatës për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit të kërkesës, pra ka kaluar afati ligjorë prej 3 viteve brenda të cilit afat paditësi ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit përmes gjykatës, nga se që nga arritshmëria e kërkesave-diferencës së pagave të cilat kërkesa rezultojn duke filluar nga data 01.01.2014 e deri me datën 15.10.2014, e në bazë të dispozitave të lartëcekura afati i parashkrimit për secilën diferencë në pagë fillon të rrejdhet pas çdo arritje për pagesë të diferencës së pagave, e çë në rastin konkret diferenca në pagë për mujin janar 2014 është arritur për pagesë me datën 31.01.2014, e afati i parashkrimit për këtë dhënje ka filluar të rrejdhet që nga data 01.02.2014, ndërsa parashkrimi i kësaj kërkesa ka arritur me datën 01.02.2017, e kështu me radhë, ndërsa dhënja e fundit për pagesë e diferencës në pagë datës 15.10.2014 është parashkruar me datën 16.10.2017, ndërsa padinë paditësi në këtë gjykatë e ka ushtruar me datën 21.03.2019, çka do të thotë se e tërë kërkespacia e paditësit ka arritur afatin e parashkrimit, gjejësishtë padia është ushtruar pas një viti e pesë muaj pas parashkrimit të dhënjes së fundit. Me qenëse e paditura është thirrur në parashkrim të kërkesës së paditësit, gjykata e ka vërtetuar faktin se në këtë çështje juridike civile kërkesa e paditësit ka arritur afatin e parashkrimit të parapar me ligj dhe mbi këtë bazë kërkesëpadinë e paditësit e ka refuzuar si të pabazuar.

Gjykata i ka vlerësuar edhe pretendimet e paditësit se të njëjtit ka ushtruar kërkesë të e paditura lidhur me objektin e këtij kontesti me datën 15.10.2015, ndërsa përgjigjen në kërkesë nga e paditura e ka paraparë me datën 24.03.2016, ndërsa i njëjti i është drejtuar me kërkesë edhe TEB në Turqi me datë 06.04.2016, por ka gjetur se një kërkesë e tillë e bërë nga paditësi ndaj të paditurës nuk ndikojn në ndërprerjen e parashkrimit, nga se konform nenit 372 të LMD-së parshihet se *“Për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin”*. Gjykata vlerëson se te kërkesat me kërkesa në para, shterrimi i mjeteve të brendshme në këtë rastë te e paditura nuk është i domosdoshëm dhe paditësi me këtë rastë pavarsishtë ushtrimin të kërkesës marrjes apo mos marrjes së përgjigjes në kërkesë, ka mundur drejtpërderejt të ushtroj padi në gjykatë.

Gjykata, mbi bazën e të lartëcekurave, dhe për shkak të ekonomizimit të procedurës e ka revokuar aktevdiminin e saj me të cilin ishte aprovuar në seancën përgaditore marrja e provës

përmes ekspertizës financiare si dhe dëgjimin e dëshmitarit A. S nga se e paditura nuk i ka kontestuar faktet për të cilat ishte propozuar të dëgjohej dëshmitari.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore gjykata konform nenit 452 paragrafi 1 vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë për përfaqësimin për një seancë gjyqësore në shumë prej 80 euro ashtu siç është kërkuar nga i autorizuari i paditurës.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform dispozitave të lartcekura e, lidhur me nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.229/2019, më datë 09.11.2020

Gj y q t a r i,
Besnik Pireva d.v

UDHËZIM JURIDIK - Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.